

RAPORT I NDËRMJETËM 3* 15 janar – 3 shkurt 2007

I. PËRMBLEDHJE

- Partitë e shumicës parlamentare dhe ato në opozitë kanë krijuar dy aleanca politike. Partitë në secilën aleancë do të kenë kandidatë të përbashkët për kryetarë bashkie dhe komune, por lista të veçanta kandidatësh për këshillat vendore.
- Partitë dhe kandidatët janë duke zhvilluar një fushatë aktive në të gjithë vendin. Deri tani janë vënë re disa probleme lidhur me fushatën, përfshirë sulme verbale, prishje posterash dhe, një grindje mes aktivistësh partish, shoqëruar me përdorim armësh. Media po e mbulon gjerësisht fushatën zgjedhore. Partive u është dhënë një minutazh falas, siç parashikohet në ligj, dhe në televizionin publik ka pasur debate midis kandidatëve.
- Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ende nuk është zgjeruar me dy anëtarë të rinj siç parashikohet në ndryshimet e Kodit Zgjedhor të datës 13 janar. Përveç kësaj, mandati i kryetarit aktual të KQZ-së përfundon më 11 shkurt.
- Komisionet Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV) u formuan brenda afateve ligjore, por jo në të gjithë rastet numri i anëtarëve ishte i plotë. Partitë vazhdojnë të shfrytëzojnë gjerësisht të drejtën e tyre për të zëvendësuar anëtarët e KZQV-ve në çdo kohë.
- KZQV-të kanë regjistruar kandidatët për kryetarë bashkie dhe komune si dhe listat e kandidatëve për këshillat vendore. Në disa raste regjistrimi i kandidatëve të pavarur duket se është penguar.
- Listat paraprake të zgjedhësve janë shpallur dhe afishuar për t'u kontrolluar nga publiku. Zgjedhësit kanë kohë deri në 6 shkurt për të verifikuar të dhënat e tyre dhe për të kërkuar korrigjime.
- Për të vënë në zbatim marrëveshjen e 13 janarit, KQZ-ja ka nxjerrë një udhëzim mbi mënyrën e identifikimit të zgjedhësve që kanë emigruar jashtë vendit, gjë që ka krijuar shqetësim pasi diskriminon disa zgjedhës dhe zbatimi i tij mund të mohojë të drejtën e zgjedhësve për të votuar. Në disa lokalitete, grupet dypalëshe të ngarkuara me identifikim e këtyre shtetasve nuk u formuan, dhe/ose përfaqësues të opozitës lokale nuk u përshinë në to.
- Lëshimi i certifikatave të lindjes si një mjet identifikimi për zgjedhësit mbetet një çështje e debatuar. Opozita ka pretenduar se qeveria bën të mundur lëshimin e certifikatave pa patur prova identiteti. Partitë e shumicës parlamentare kanë pretenduar

* Ky raport është i përkthyer në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

se organet e pushtetit vendor, të kontrolluara prej opozitës, kërkojnë një numër të parsyeshëm dokumentacioni mbështetës nga shtetas për të cilët kanë dijeni apo besojnë se mbështesin partinë në pushtet.

- KQZ-ja ka gjykuar, në një mënyrë profesionale dhe transparente, më shumë se 50 kërkesa ankimore. Në 14 raste KQZ-ja pranoi kërkesën dhe rrëzoi vendimin e KQZV-së. Deri më 1 shkurt ishin paraqitur në Kolegjin Zgjedhor katër apeline kundër vendimeve të KQZ-së.
- Presenca e OSBE-së në Tiranë po mbështet KQZ-në në përpjekjet e saj të rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi rregullat e reja të lëshimit dhe përdorimit të certifikatave.

II. KLIMA E FUSHATËS

Pas shtyrjes së datës së zgjedhjeve për në 18 shkurt, shumica e partive nisën menjëherë fushatën. Partitë në pushtet nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në 17 janar, e cila përfshin nëntë parti të shumicës dhe është quajtur ‘Koalicioni i Madh’ nga Kryeministri Sali Berisha. Ky grupim përfshin të gjitha partitë e djathta parlamentare, me përjashtim të Partisë së Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, e cila do të negociojë aleanca të veçanta në nivel vendor. Ai përfshin edhe tre parti jo-parlamentare. Marrëveshja parashikon kandidatë të përbashkët për kryetarë bashkie dhe komune në të 384 njësitë e qeverisjes vendore, por lista të ndara kandidatësh për anëtarë të këshillave për secilën parti.

Më 18 janar, partitë e opozitës u bashkuan në një aleancë pesë partish, të cilat gjithashtu do të prezantojnë kandidatë të përbashkët për kryetarë të bashkive e komunave dhe lista të veçanta partish. Megjithatë, ato nuk mundën të binin dakord mbi rreth 11 njësi të qeverisjes vendore, ku do të konkurrojnë me njëra-tjetrën për postet e kryetarëve të komunave.

Kjo strategji ka çuar në krijimin e një farë konflikti të brendshëm brenda të dy aleancave. Në disa raste kryetarë aktualë bashkish apo komunash dhe anëtarë të këshillave vendore, të cilët nuk janë emëruar prej aleancave ku bëjnë pjesë, kanë vendosur të regjistrohen si kandidatë të pavarur. Këto raste kanë ngritur shqetësim brenda partive, në mënyrë të veçantë brenda PS-së. Aktivistë të partisë ngritën publikisht pyetjen nëse marrëveshjet e negociuara mohonin politikën e PS-së ‘një anëtar - një votë’ për përzgjedhjen e brendshme të kandidatëve. Udhëheqja e PS-së ka kritikuar ata që kanë zgjedhur të kandidojnë si të pavarur, duke vënë në dukje pasojat serioze në rast se kandidimi i tyre rezulton në fitore të kandidatëve të shumicës.

Fushata ka qenë e dukshme në të gjithë vendin. Partitë dhe alenacat organizuan ceremoni të mëdha për hapjen e fushatës në Tiranë gjatë fundjavës së 20-21 janarit. Shumica e mitingjeve janë organizuar në të gjithë vendin, në kontekstin e dy aleancave të mëdha politike. Në mitingjet e vëzhguara opozita është përqendruar kryesisht në kritikën ndaj veprimtarsë së qeverisë aktuale dhe në përmirësimin e infrastrukturës. Shumica parlamentare është përqendruar në përmirësimin e kushteve të jetesës, kujdesit social, infrastrukturës, uljes së korrupsionit, dhe kritikave ndaj PS-së dhe udhëheqësve të saj.

Në fillim të fushatës, sulme verbale personale lëshuar prej lidërshepeve të partive, përbënë shqetësim, por kanë ardhur duke u pakësuar. Kjo çështje u ngrit prej 6 OJF-ve të ngarkuara

nga Presidenti Alfred Moisiu për të monitoruar zbatimin nga ana e partive të Kodit të Sjelljes sugjeruar prej tij më 19 janar. Edhe pse Kodi i Sjelljes nuk është nënshkruar, Zyra e Presidentit është shprehur se partitë kanë rënë dakord verbalisht për respektimin e tij.

Një tjetër çështje e diskutuar ka qenë grisja e posterave të fushatës prej partive kundërshtarë. Në pak raste, kandidatë të pavarur kanë përvetësuar logot e partnerëve të tyre të mëparshëm dhe i kanë përdorur në fushatën dhe posterat e tyre. Edhe pse shumica e këtyre rasteve janë zgjidhur pa incidente, një rast në Gjirokastrë çoi në një grindje mes aktivistëve të PS-së dhe PD-së, që përfundoi me përdorim armësh dhe një arrestim. PS-ja deklaroi që kandidati i tyre në këtë rreth ngacmohet nga policia për arsye partiake, gjë që mohohet prej policisë.

Disa akuza janë ngritur lidhur me përpjekjet për të ndikuar mbi votën e zgjedhësve, sidomos mes komunitetit Rom. Në Pogradec, Prefekti i Korçës dhe kandidati për kryetar bashkie i PD-së janë filmuar duke shpërndarë thasë me sheqer dhe dyshekë gjatë një takimi me komunitetin Rom. Prefekti as nuk konfirmoi, por as nuk mohoi që këto artikuj ishin shpërndarë gjatë takimit.

Partia Socialiste në 2 shkurt dërgoi një letër pranë Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, në të cilën paraqiste shqetësimet e veta lidhur me procesin zgjedhor dhe veprime të cilat kjo parti pretendon se mund të minonin integritetin e zgjedhjeve. Mes të tjerash, PS-ja përmend mos-emërimin e dy anëtarëve të rinj të KQZ-së; mungesën e transparencës lidhur me prokurimin dhe specifikimet e bojës që nuk hiqet e që do të përdoret në ditën e zgjedhjeve dhe pamundësisë për të disponuar kampione të kësaj boje; procedura tenderimi jo transparente për printimin e fletëve të votimit dhe shkeljen e procedurave përkatëse; informacioni i pamjaftueshëm që Kryetari i KQZ-së u jep anëtarëve të tjerë të komisionit dhe përfaqësuesve të partive; dyshimin për presion të ushtruar mbi nëpunës të qeverisë për të marrë pjesë në mitingjet e partisë në pushtet; dhe shqetësimet lidhur me përditësimin e listave të zgjedhësve, lëshimin e certifikatave dhe edukimin e zgjedhësve.

III. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Marrëveshja politike e 30 gushtit 2006 dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor të datës 13 janar, parashikojnë emërimin prej Kuvendit të dy anëtarëve të rinj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë periudhës që mbulon ky raport, Lëvizja Socialiste për Integrim dorëzoi një kandidaturë, por Partia Demokratike nuk arriti ta bëjë diçka të tillë. LSI deklaroi që kjo është bërë në mënyrë të qëllimshme prej shumicës në pushtet, për të bllokuar anëtarin e tyre të ri. Nga ana tjetër, Nënkryetari i Kuvendit¹, argumentoi që të dy partitë të dorëzojnë dy kandidatura secila, në mënyrë që të respektohet e drejta e Kuvendit për të “zgjedhur” anëtarët e rinj.²

¹ Nënkryetari i Kuvendit, Z. Fatos Beja, (PD) është edhe kryetar i Komisionit Parlamentar të Ligjeve, i cili ka përgjegjësinë të vlerësojë përputhjen e kandidaturave për anëtarësi në KQZ me kërkesat ligjore para se këto kandidatura të paraqiten në seancë plenare.

² Rekomandimet e përbashkëta të vitit 2004 të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias shprehen se: “Këto dispozita kufizojnë numrin e kandidaturave që mund të merren në shqyrtim nga tri institucionet kushtetuese kur zgjedhin një anëtar për plotësimin e vendit vakant në KQZ. Këto dispozita kufizojnë të drejtën kushtetuese të institucioneve emëruese në një listë me jo më shumë se dy kandidatura të propozuara nga subjekte që nuk parashikohen nga neni 154 (“parti/grupe politike”). Togfjalëshi “jo më shumë se dy” i rëndon shqetësimet kushtetuese, pasi lejon që lista të jetë e kufizuar në një emër të vetëm, duke sjellë për rrjedhojë shfuqizimin e plotë të të drejtës kushtetuese të tri institucioneve

Megjithëse dy anëtarët e rinj të KQZ-së nuk u emëruan nga Kuvendi deri në fund të periudhës që mbulon ky raport, KQZ-ja mundi të marrë vendime duke respektuar shumicën e re prej pesë votash, gjë që kërkonte një shkallë më të lartë konsensusi mes anëtarëve të KQZ-së.

Mandati i Kryetarit të KQZ-së përfundon në 11 shkurt, gjashtë muaj pas zgjedhjes së tij. Ndryshimet e reja (Neni 27, pika 1, gërma “dh”) specifikojnë që Kryetari do të zgjidhet me votim të fshehtë mes nëntë emrave të anëtarëve të KQZ-së, me një shumicë të cilësuar prej gjashtë votash. Në rast se asnjë prej anëtarëve nuk merr shumicën e kërkuar të votave, një raund i dytë votimi organizohet “mes anëtarëve që kanë marrë më shumë vota”. Ai anëtar që merr numrin më të lartë të votave zgjidhet kryetar i komisionit. Anëtarët e KQZ-së duket se presin vendimin e Kuvendit për emërimin e anëtarëve të rinj, para se të votojnë për kryetarin e KQZ-së.

KQZ-ja është përballur me probleme serioze logjistike në ngritjen e KZQV-ve. Sipas dispozitave kalimtare të Kodit Zgjedhor, ato duhej të ishin ngritur brenda shtatë ditëve që prej hyrjes në fuqi më 13 janar të ndryshimeve në Kod. KQZ-ja vendosi datat 20 dhe 21 janar si datat e mbledhjeve të para të KZQV-ve, në mënyrë që KZQV-të e komunave në zonat e largëta të kishin kohë të mjaftueshme për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore. Zgjerimi i KZQV-ve nga shtatë në trembëdhjetë anëtarë e vështirësoi procesin e emërimit të KZQV-ve me anëtarësi të plotë. Megjithatë, të 384 KZQV-të kanë të paktën kuorumin e kërkuar, me shtatë anëtarë dhe një sekretar, dhe të gjitha duket se e kanë mbajtur mbledhjen e tyre të parë brenda afateve të caktuara nga KQZ-ja. Fakti që shumë anëtarë të KZQV-ve kanë eksperiencë të mëparshme në administrimin e zgjedhjeve përbën një avantazh.

Sikurse dhe në zgjedhjet e mëparshme, partitë politike kanë shfrytëzuar gjerësisht të drejtën e tyre për të zëvendësuar anëtarët e KZQV-ve. Kjo ka çuar në një shkallë pasigurie në një numër të KZQV-ve. Disa anëtarë u emëruan pas trainimit të anëtarëve të KZQV-ve dhe në disa raste kryetarët e KZQV-ve janë ndërruar pa u njoftuar më parë prej partive që i kishin emëruar, gjë që ka krijuar konfuzion. Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve i është thënë se këto ndryshime korrespondojnë me emërimin e kryetarëve që duket se janë më afër kandidatit të partisë së tyre në lokalitetin përkatës.

Në përputhje me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, në 18 janar KQZ-ja vendosi mbi numrin e Grupeve të Numërimit për bashki dhe komunë, bazuar në numrin e Qendrave të Votimit nën juridiksionin e çdo KZQV-ve.

Tenderi i hapur për printimin e fletëve të votimit u fitua nga një kompani shtetërore italiane “Zecca dello Stato”, e cila prodhon formularë zyrtarë dhe kartmonedha. Printimi i fletëve të votimit ka nisur.

Një buxhet i përshtatur me zgjerimin e administratës zgjedhore ende nuk është miratuar nga qeveria. Më 21 janar u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi mes KQZ-së dhe kompanisë shtetërore të energjisë, KESH, sipas të cilit ajo do të sigurojë energji elektrike në mënyrë të pandërprerë për të gjitha ambjentet e administratës zgjedhore gjatë periudhës së votimit dhe numërimit të votave.

emëruese. Kjo i shndërron këto tri institucione kushtetuese thjesht në “vulosës formalë” të procesit të emërimit të KQZ-së sipas nenit 154.”

IV. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Afatet e ngjeshura kohore të vendosura prej dispozitave kalimtare të Kodit Zgjedhor të ndryshuar lidhur me ngritjen e KZQV-ve dhe regjistrimin e kandidatëve rezultuan në një sfidë si për KZQV-të ashtu edhe për kandidatët. Sipas këtyre dispozitave, kandidatët duhej të regjistroheshin brenda dhjetë ditëve pasi ndryshimet në kod të kishin hyrë në fuqi, kohë në të cilën KZQV-të sapo ishin krijuar dhe shpesh ishin në proces trainimi. KQZ-ja vendosi t'u jepte KZQV-ve 24 orë shtesë për të pranuar dokumentat e emërimit të kandidatëve. KZQV-të kanë regjistruar një total prej 1,073 kandidatësh për kryetarë bashkie apo komune, 6,074 kandidatësh për këshilltarë në listat e partive dhe të koalicioneve për këshillat vendore dhe 212 kandidatë të pavarur për këshilltarë. Vetëm 33 kandidatë për kryetarë janë gra.

Vëzhguesit afatgjatë të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it kanë raportuar një numër rastesh kur individë të ndryshëm janë penguar në përpjekjet e tyre për t'u regjistruar si kandidatë të pavarur. Kjo ka ndodhur sidomos në rastet kur aplikuesit kanë qënë anëtarë partish apo zyrtarë aktualë të administratës vendore, të cilët nuk ishin propozuar prej kryesive të partive të tyre. Në shumicën e rasteve të vëzhguara regjistrimi u është mohuar prej KZQV-ve duke vënë në diskutim nënshkrimet mbështetëse.

Dorëzimi i dokumentacionit për regjistrimin e Z. Akile Rama në garën për kryetarin e bashkisë së Tiranës ngjalli gjithashtu debat. Propozimi i Z. A.Rama si kandidat u bë prej Partisë së Ballit Kombëtar dhe u pranua nga KZQV-ja e Tiranës, që do ta kishte vendosur emrin e tij mbi emrin e liderit të Partisë Socialiste Z. Edi Rama. Thuhet se, kur u kontaktua nga media dhe nga PS-ja, Z. A. Rama nuk ishte në dijeni të emërimit të tij si kandidat dhe i kërkoi KZQV-së të tërhiqte kandidaturën e vet. KZQV-ja e bëri këtë, megjithatë PS-ja ka bërë kallzim në prokurori, duke ngritur akuzën për falsifikim të nënshkrimeve në këtë rast. Një hetim është në proces e sipër.

V. LISTAT E ZGJEDHËSVE

Në përputhje me detyrimin ligjor, të gjitha bashkitë dhe komunat kanë dërguar listat paraprake të zgjedhësve në Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC) pranë Ministrisë së Brendshme. DPGJC-ja ka kontrolluar të gjitha listat për duplikata mes njësive të qeverisjes vendore, të cilat duhet të zgjidhen nga organet përkatëse të qeverisjes vendore. Gjithashtu, DPGJC-ja i pajisi Zyrat e Gjendjeve Civile (ZGJC) me një program “filtër” i cili mundëson përfshirjen automatike në listat e zgjedhësve të personave që mbushin 18 vjeç deri në ditën e zgjedhjeve. ZGJC-ve u janë dhënë udhëzime për të bërë ndryshimet e nevojshme në bazë të informacionit të marrë nga DPGJC-ja. Për sa u përket zgjedhësve me adresë numerike të paplotë (të ashtuquajturat rastet “999”, DPGJC-ja i ka udhëzuar të gjitha ZGJC-të t'u kërkojnë qytetarëve adresën e tyre të saktë kur ata kërkojnë certifikata lindjeje.

Listat e zgjedhësve janë shpallur në pjesën më të madhe të komunave dhe bashkive, megjithëse afati ligjor i 21 janarit jo gjithmonë u respektua. Zgjedhësit kanë kohë deri në 6 shkurt për të verifikuar të dhënat e tyre në listat e zgjedhësve dhe për të kërkuar shtesa ose korrigjime nëse është e nevojshme. Listat përfundimtare të zgjedhësve duhet të miratohen nga kryetarët e njësive të qeverisjes vendore dhe t'u dërgohen KZQV-ve më 7 shkurt. KZQV-të duhet t'i shpallin listat më 8 shkurt. Më pas zgjedhësit mund të kërkojnë ndryshime në

Gjykata deri më 16 shkurt. Gjykatat mund të japin vendime deri në orën 12:00 në ditën e zgjedhjeve.

Pas marrëveshjes së 13 janarit, KQZ-ja u ngarkua të nxirrte një udhëzim për mënyrën se si Grupet e Njoftimit dhe Verifikimit (GNJV-të) duhet t'i identifikojnë personat të cilat kanë emigruar jashtë vendit, në mënyrë që ata të shënohen siç duhet në listën e zgjedhësve.

Vendimi u mor pas debatesh të forta në KQZ që zgjatën disa ditë dhe u karakterizuan nga shqetësimi për mohimin e mundshëm të të drejtës e zgjedhësve për të votuar dhe për mundësinë e antikushtetutshmërisë së Udhëzimit. Ky aspekt i Marrëveshjes së 13 janarit ka ngritur shqetësime për sa i përket pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor meqënëse diskriminon midis zgjedhësve, dhe në lidhje me mundësinë për të mohuar të drejtën e zgjedhësve për të votuar. Përveç kësaj, disa zgjedhës mund të mësojnë që janë shënuar si emigrantë vetëm pas shpalljes së listës përfundimtare të zgjedhësve në 8 shkurt, duke e kufizuar mundësinë për të kërkuar korrigjim në Gjykatën e Rrethit.

KQZ-ja vendosi ta lidhte njoftimin e zgjedhësve nga autoritetet e qeverisë vendore me identifikimin e emigrantëve. Duke pasur parasysh kohën e kufizuar, KQZ-ja ua kaloi KQZV-ve përgjegjësinë për të caktuar anëtarët e GNJV-ve. Një anëtar do të caktohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore dhe tjetri nga partia kryesore e opozitës në nivel vendor. Mesa duket, deri në fund të periudhës së raportimit, në disa lokalitete GNJV-të nuk janë caktuar ende. Mbetet për t'u parë nëse ato do të kenë kohë të mjaftueshme për të përmbushur detyrat e tyre. Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë raportuar se në disa lokalitete, pjesa më e madhe e GNJV-ve nuk janë dypalëshe.

VI. CERTIFIKATAT E LINDJES

Çështja e certifikatave të lindjes si mjet identifikimi, përfshirë edhe për qëllime votimi, mbetet e debatuar. Pas problemeve me lëshimin e tyre nga disa ZGJC, të cilat e kushtëzuan këtë shërbim publik me pagimin e taksave vendore, Ministria e Brendshme më 23 janar nxori një "kujtesë" për zbatimin e dispozitave ligjore nga ZGJC-të. Megjithëse kjo kujtesë përsërit dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe ligje të tjerë, ajo ka sjellë polemika të shumta mes Qeverisë dhe opozitës.

Në 26 janar, televizioni privat Top Channel transmetoi një filmim ku dukej të shfaqej një gazetare me kamera të fshehtë e cila ia kishte dalë me sukses të paraqitej si një qytetare tjetër për të marrë një certifikatë në një njësi vendore të drejtuar nga PD-ja. PS-ja pretendoi se "kujtesa" e 23 janarit lehtësonte marrjen e një certifikate lindjeje pa paraqitur prova identiteti. PD-ja nga ana e saj, pretendoi se punonjësit e ZGJC-së në lokalitetet e kontrolluara nga PS-ja u kërkojnë qytetarëve që besohet se mbështesin PD-në një numër të paarsyeshëm dokumentesh mbështetës.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka kërkuar sqarim të kësaj çështjeje nga Zëvendës Ministri i Brendshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i DPGJC-së. Ata thanë se nuk ka dispozita ligjore të cilat do ta standardizonin lëshimin e certifikatave të lindjes për qytetarët dhe theksuan se qytetarët që kërkojnë për herë të parë të pajisen me certifikatë ka të ngjarë të mos kenë dokument tjetër mbështetës. Vakumi ligjor për sa i përket lëshimit të certifikatave të lindjes në mungesë të dokumentacionit mbështetës mund të mbulohet nga parimi i Ligjit të Gjendjes

Civile që përcakton se punonjësit e ZGJC-së nuk mund të lëshojnë certifikata të falsifikuara, dhe se ata qytetarë duhet t'u sigurojnë ZGJC-ve të dhëna të vërteta për identitetin e tyre. Legjislacioni parashikon përgjegjësi penale në rast falsifikimi.

Kodi Zgjedhor i ndryshuar përcakton krijimin e grupeve të cilat duhet të monitorojnë aktivitetet e ZGJC-ve në secilën nga njësitë e qeverisjes vendore qendër qarku. Anëtarët e grupeve duhet të caktohen nga Prefekti, dhe të paktën njëri prej tyre duhet të propozohet nga partia kryesore në opozitë në nivel vendor. Në Tiranë, disa kryetarë të njësisve vendore refuzojnë praninë e këtyre grupeve monitoruese. Ata argumentojnë se ligji nuk i parashikon këto grupe monitoruese në nivelin e njësisve bashkiake, por vetëm në nivelin e Bashkisë së Tiranës; megjithatë, certifikatat e lindjes për qëllime votimi lëshohen vetëm në nivelin e njësisve bashkiake.

Drejtori i Përgjithshëm i DPGJC-së e vuri në dijeni MVZ-në e OSBE/ODIHR-it për ngirtjen e një grupi pune me tre persona pranë Drejtorisë,, të cilët do ta studionin problemin dhe do të hartonin propozime mbi mënyrat e standardizimit të procedurave. Ndërkohë që zgjidhja duhet të rrisë integritetin e procesit, ajo nuk duhet të ndikojë negativisht në mundësinë e qytetarit për të ushtruar të drejtën për të votuar.

VII. ANKIMET DHE APELIMET

Ankimet e para u depozituan në KQZ pas mbarimit të afatit ligjor të regjistrimit të kandidatëve nga KQZV-të. Gjatë periudhës 25-31 janar, KQZ-ja regjistroi dhe mori vendime për më shumë se 50 ankime. Këtu përfshiheshin 10 ankime nga individë të cilëve u ishte mohuar regjistrimi si kandidatë të pavarur, rreth 20 ankime nga partitë politike të cilat kundërshtuan refuzimin e regjistrimit të kandidatëve të tyre për kryetarë bashkie dhe komune dhe të kandidatëve për anëtarë këshillash, rreth 10 ankime nga partitë politike që pretendonin regjistrim të paligjshëm të kandidatëve të pavarur, dhe disa ankime nga kandidatët e mbështetur nga partitë.

KQZ-ja pranoi 14 ankime. Rrjedhimisht, ajo rrëzoi vendimet e KQZV-ve dhe udhëzoi KQZV-të të regjistronin dy kandidatë për kryetarë nga partitë politike, dy kandidatë të pavarur, dhe pesë lista kandidatësh për këshilltarë. Gjithashtu, pas katër ankimesh për të njëjtën çështje, KQZ-ja udhëzoi KQZV-në e Shëngjinit të çregjistronte një kandidat të pavarur për kryetar bashkie. 18 ankime u hodhën poshtë si të pabazuara, ndërkohë që të tjerat u hodhën poshtë pa u shqyrtuar në themel ose nuk u pranuan për shqyrtim për shkak të paraqitjes me vonesë ose për arsye të tjera procedurale.

Në shumë raste, kundërshtimi i vendimeve të KQZV-ve për rrëzimin e kandidatëve u bazua në mangësi të listave të nënshkrimeve mbështetëse të paraqitura në përputhje me nenin 81 të Kodit Zgjedhor. Besueshmëria e këtyre arsyeve mbetet e debatueshme, duke pasur parasysh mungesën e ndonjë udhëzimi apo orientimi të KQZ-së mbi kriteret dhe metodat për verifikimin nga KQZV-të e nënshkrimeve mbështetëse.

Megjithëse afatet kohore për gjykimin e ankimeve nga KQZ-ja janë shkurtuar në mënyrë të ndjeshme nga ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor (nga 10 ditë në dy ditë, me përjashtim të ankimeve që kanë të bëjnë me rezultatet e zgjedhjeve), deri tani KQZ-ja ka arritur ta respektojë këtë afat. KQZ-ja i ka shqyrtuar ankimimet në një mënyrë transparente dhe

profesionale, duke bërë publike ditën dhe orën e seancave dhe duke u dhënë ankuesve ose përfaqësuesve të tyre një mundësi për të paraqitur argumentet dhe provat e tyre.

Deri në 3 shkurt 2007, në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit të Tiranës janë paraqitur nëntë apeline. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e pushtetit vendor dhe nuk janë shqyrtuar ende. MZV-ja e OSBE/ODIHR do të ndjekë seancat gjyqësore dhe raportoje mbi to..

VIII. MEDIA

Media e monitoruar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vazhdon t'u sigurojë zgjedhësve një informacion të gjerë mbi çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Fushata në media është përqëndruar më shumë tek personalitetet sesa tek platformat politike, ku dy koalicionet e mëdha politike kanë pasur pjesën më të madhe të mbulimit.

Televizioni Publik Shqiptar (TVSH) deri tani i është përmbajtur detyrimit të tij ligjor për t'u ofruar minutazh falas të gjitha partive politike të regjistruara në zgjedhje. Megjithatë, deri tani partitë kanë treguar pak interes dhe vetëm pak më shumë se gjysma e tyre kanë përdorur një pjesë ose të gjithë minutazhin e tyre falas. Debatet mes kandidatëve që kandidojnë në qytetet kryesore janë transmetuar rregullisht në TVSH, duke u dhënë votuesve informacion dhe kandidatëve një mundësi për të shkëmbyer pikëpamjet e tyre. Megjithatë, asnjëri nga kandidatët për kryetar bashkie të Tiranës, Z.Edi Rama (PS) dhe Z.Sokol Olldashi (PD) nuk ka pranuar një ftesë nga TVSH-ja për të debatuar së bashku.

Bordi i Monitorimit të Medias i KQZ-së (BMM) nisi aktivitetet e tij të monitorimit të medias më 22 Janar, tri ditë pas nisjes zyrtare të fushatës. BMM-ja paraqiti raportet e saj të para në 27 janar dhe 3 shkurt. Në raportin e parë, BMM-ja vërejti se një pjesë e mbulimit në media nuk ishte bërë në përputhje me legjislacionin mbi median, por nuk i rekomandoi KQZ-së që të vinte sanksione. KQZ-ja e miratoi raportin e parë të BMM-së pas diskutimesh të gjata dhe nuk vendosi sanksione ndaj asnjë transmetuesi televiziv. Megjithatë, pas raportit të dytë, KQZ-ja urdhëroi disa media, përfshirë TVSH-në, TV Klan, Top-Channel dhe Vizion+, të "korrigjonin" mbulimin e tyre të njëanshëm brenda 48 orëve.

Sipas ligjit televizionet publike ashtu edhe ato private duhet t'u sigurojnë partive 'të mëdha' (PD e PS) "dyfishin e minutazhit" të caktuar për çdo parti 'të vogël' parlamentare. Megjithatë, konstatimet e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it tregojnë se PD-ja dhe PS-ja kanë pasur një minutazh më të madh mbulimi sesa përcakohet në ligj. Përveç kësaj, ato kanë mbizotëruar edhe në biseda në studio dhe debate politike.

Me nisjen e periudhës zyrtare të fushatës, TVSH-ja i ka dhënë PD-së dhe PS-së një mbulim afërsisht të barabartë në programin kryesor të lajmeve, i cili ka pasur një ton kryesisht pozitiv. Kur PS-ja pati disa mbulime negative në programin e lajmeve në TVSH, ato ishin kryesisht në lidhje me kritika ndaj Z.Rama.

Kanali televiziv privat TV Klan vazhdoi t'ia kushtonte pjesën më të madhe të informacionit politik Qeverisë (26 përqind). Dy partitë kryesore patën kohë të barabartë mbulimi, kryesisht me ton pozitiv dhe neutral. Në të kundërt, televizioni kombëtar privat TVA i kushtoi më shumë kohë PS-së. Ndryshe nga stacionet televizive të monitoruara, ai vazhdoi t'i jepte

Lëvizjes Socialiste për Integrim një mbulim të favorshëm, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor.

Top Channel, Vizion + dhe Neës 24 i kushtuan më shumë kohë PD-së, por toni si për PD-në, ashtu edhe për PS-në ishte pozitiv dhe neutral. Mes stacioneve të monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, Top Channel që më shumë kritikues ndaj Qeverisë (rreth gjysma e mbulimit për Qeverinë u vlerësua se kishte një ton negativ).

Fushata publike në media është bërë më e nxehtë gjatë periudhës së raportimit. Më 31 janar, PS-ja nisi një fushatë me reklama duke përdorur imazhe fyese ndaj figurës së kandidatit të PD-së Sokol Ollidashi. Në 2 shkurt, PD-ja u kundërpërgjigj me reklamën e saj fyese ndaj kandidatit të PS-së, Edi Rama. Reklama të tilla kanë shërbyer vetëm për ta polarizuar fushatën mediatike.

IX. AKTIVITETET E MISIONIT TË VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE TË OSBE/ODIHR

Gjatë periudhës që mbulon ky raport, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR vazhdoi me aktivitetet e veta dhe po përgatitet aktivisht për mbërritjen e vëzhguesve afatshkurtër. Kreu i Misionit dhe anëtarët e misionit kanë zhvilluar takime me zyrtarë shtetërorë, përfaqësues të partive, kandidatë, me administratën zgjedhore, përfaqësues të medias dhe të shoqërisë civile. Në datat 18 janar dhe 1 shkurt u mbajtën dy takime informuese me përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Vëzhguesit afatgjatë të shpërndarë në të gjithë vendin vazhdojnë të vëzhgojnë situatën para-zgjedhore nëpër qarqe dhe po përgatiten për shpërndarjen e vëzhguesve afatshkurtër.